



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

Tiranë, më 19.03.2021

RAPORT
(Për dhënie mendimi)

PËR
PROJEKTLIGJIN

"PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË ANGAZHIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, DHE ALEANCËS GAVI, PËR PJESËMARRJEN NË STRUKTURËN GLOBALE TË QASJES NË VAKSINAT COVID-19 (COVAX FACILITY), MIRATUAR ME LIGJIN NR.134/2020"

- Hyrje

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 19.03.2021, mori në shqyrtim projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës Gavi, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat covid-19 (covax facility), miratuar me ligjin nr.134/2020".

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm dhe përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale, Znj. Mira Rakacolli, Zëvendësministre.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT, VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti i Këshillit të Ministrave propozohet në mbështetje të neneve 81, pika 1, 83, pika 2, 100, dhe 121, pika 1, shkronja "d", të Kushtetutës dhe të neneve 12, 17, dhe 23, të ligjit nr.43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Marrëveshja ndryshuese është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr.86, datë 12.2.2021.

Për arsye se marrëveshja fillestare është ratifikuar nga Kuvendi me anë të ligjit 134/2020, në zbatim të nenit 121, pika 1, shkronja “d”, i cili parashikon se marrëveshjet ndërkombëtare që parashikojnë miratimin, ndryshimin, plotësimin ose shfuqizimin e ligjeve, ndryshimet e kësaj marrëveshjeje, pas miratimit në parim, duhet t’i nënshtrohen procedurave ligjore që parashikon neni 17, i ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Për shkak të urgjencës që paraqet mundësimi i Lehtësisë Covax për të zhvilluar bisedime me prodhues të ndryshëm për blerjen e vaksinës kundër COVID-19, propozohet që marrëveshja të kalojë për shqyrtim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë me anë të procedurës së përshpejtuar, e cila parashikohet në nenin 83, pika 2, të Kushtetutës.

Ky projektligj nuk bën pjesë në projektligjet e parashikuara në nenin 81, pika 2, të cilët nuk mund t’i nënshtrohen procedurës së përshpejtuar, prandaj nuk ka pengesa që të kalojë me procedurë të përshpejtuar.

Projektligji i propozuar është në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Qëllimi i projektligjit është miratimi i ndryshimeve të marrëveshjes ekzistuese së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI. për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (*COVAX Facility*), e cila është miratuar me ligjin nr.134/2020.

Ky projektligj ka për qëllim që të ratifikojë ndryshimet që janë propozuar nga Aleanca GAVI në marrëveshjen e angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Aleancës GAVI, për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (*COVAX Facility*).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e Aleancës GAVI dhe është njoftuar se shumica e furnizimeve me vakcina është bërë në kushtet kur vaksinat kanë marrë autorizimin e përdorimit emergjent. Aleanca GAVI ka propozuar që në vend që GAVI të kërkojë heqje dorë sa herë që një furnizues vaksine i ofrohet një pjesëmarrësi, një ndryshim në marrëveshjen aktuale të angazhimit për të rregulluar statusin e autorizimeve të përdorimit emergjent. Ky ndryshim lejon të përshpejtohet caktimi i vaksinave që kanë marrë autorizimin e përdorimit emergjent në mënyrë që të mos vonohet me alokimin e tyre.

Marrëveshja përmban parashikimet e mëposhtme:

1. Ndryshime/Amendime

- 1.1 Duke hyrë në fuqi nga data e siglimit të kësaj letre ndryshimi nga pjesëmarrësi, marrëveshja e angazhimit do të ndryshohet, në përputhje me klauzolën 14.4 (*Ndryshimet dhe heqjet dorë*) të marrëveshjes së angazhimit, si më poshtë:

1.1.1 Në klauzolën 1.1 (b) (*Përkufizimet*) e marrëveshjes së angazhimit dhe shtojcën 1 (*Fjalorthi i termave*) të termave dhe kushteve, përkufizimi i vaksinës së miratuar do të ndryshohet, si më poshtë:

“Vaksinë e miratuar” nënkupton një vaksinë kundër COVID-19 në lidhje me të cilën Gavi ka ndërmarrë një angazhim të përparuar të blerjes dhe që ka ose parakualifikim të OBSH-së, autorizim standard/të kushtëzuar marketingu ose një autorizim për përdorim emergjent të vendosur nga një SRA ose Autorizim Përdorimi Emergjent të OBSH-së.

1.1.2 Në paragrafin 11 (*Angazhimi me Prodhuesit*) i termave dhe kushteve, paragrafi i dytë nën titullin “Angazhimet mbi volumin” do të ndryshohet si më poshtë:

Për prokurim, vakcina duhet të jetë vaksinë e miratuar

1.2 Palët pranojnë që paragrafi 16 i termave dhe kushteve (i cili nuk është detyrues për palët, në përputhje me klauzolën 12 të marrëveshjes së angazhimit) nuk është më i zbatueshëm.

1.3 Për të shmangur dyshimin, me anë të kësaj është rënë dakord që ndryshimet e paraqitura në këtë letër ndryshimi janë në interes të të dyja palëve dhe secila palë e pranon këtë përfitim, në konsideratë të nënshkrimit të kësaj letre ndryshimi. Ndryshimet e përcaktuara në këtë letër ndryshimi nuk do të cenojnë të drejtat dhe detyrimet e akumuluar të një pale në përputhje me marrëveshjen e angazhimit në datën kur letra e ndryshimit hyn në fuqi.

2. Të ndryshme

2.1 Pjesëmarrësi përfaqëson dhe i garanton Gavi-it se:

2.1.1 ka fuqi dhe autoritet të plotë për të hyrë, kryer dhe dorëzuar këtë letër ndryshimi dhe transaksionet e parashikuara në të;

2.1.2 Kjo letër ndryshimi është autorizuar, ekzekutuar dhe dorëzuar prej tij sipas rregullave dhe përbën detyrime ligjore të vlefshme e detyruese të tij dhe të zbatueshme ndaj tij në përputhje me kushtet e tij; dhe

2.1.3 të gjitha veprimet që duhen ndërmarrë (përfshirë marrjen e ndonjë autorizimi) për hyrjen e tij në këtë letër ndryshimi, kryerjen e transaksioneve të tjera të parashikuara këtu, ose pajtueshmërinë prej tij me kushtet e vendosura këtu, sipas rastit, janë ndërmarrë dhe të gjitha autorizimet janë në fuqi dhe efekt të plotë.

2.2 Dispozitat e klauzolave 13 (*Komunikimet*), 14 (*Të Ndryshme*), 15 (*Ligji rregullues*) dhe 16 (*Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*) të marrëveshjes së angazhimit do të zbatohen për këtë letër ndryshimi siç do të përcaktohej plotësisht në këtë letër ndryshimi dhe sikur referencat në ato klauzola të “kësaj marrëveshjeje” të ishin referenca ndaj kësaj letre ndryshimi dhe referencat ndaj “palës” ose “palëve” janë referenca ndaj palëve të kësaj letre ndryshimi.

Marrëveshja është nënshkruar nga përfaqësuesi i Covax, më datë 26.2.2021, dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, më 12.2.2021.

III. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE

Ky projektligj nuk synon përafrimin me acquis të BE-së.

IV. NSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij projektligji.

V. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, për të avancuar më tej miratimi i ndryshimeve të marrëveshjes ekzistuese së angazhimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Aleancës GAVI. për pjesëmarrjen në strukturën globale të qasjes në vaksinat COVID-19 (*COVAX Facility*), e cila është miratuar me ligjin nr.134/2020..

Z. Shameti, në cilësinë e relatorit, theksoi se synimi i këtij ndryshimi lejon të përshpejtohet caktimi i vaksinave që kanë marrë autorizimin e përdorimit emergjent në mënyrë që të mos vonohet me alokimin e tyre.

Gjatë diskutimit, Komisioni mbështeti qëndrimin e relatorit dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm.

VI. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislationin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETARI

ADNOR SHAMETI

ULSI MANJA